



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 33

Prishtinë, më 16.11.2011, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi.

Munguan : Daut Haradinaj, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MB, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës ,**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 14.11.2011,**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit për rregullimin e tokës,**
4. **Shqyrtimi i planit të veprimit për integritet evropiane, për vitin 2012,**
5. **Raporti për Token Bujqësore,**
6. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.11.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 14.11.2011.

3. Shqyrtimi i projektligjit për rregullimin e tokës

Kryetari Nait Hasani përshëndeti të pranishmit dhe menjëherë sugjeroi të vazhdoi punën komisioni rreth amendamenteve të propozuara nga ekspertët. U shqyrtuan 9 amendamentet e propozuara me disa përmirësime. Amendamenti 3 dhe 4 prapë do të shqyrtohet në fund , pasi që duhet pritur si do të vendoset për amendamentet tjera të radhës.

U caktua mbledhja për të premtën kur do të ftohen ministri i MMPH dhe MBPZHR lidhur me buxhetin e vitit 2012.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 15,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani